

RAPORTI VJETOR

AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS



AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS



RAPORTI VJETOR 2024

RAPORTIMI I AKTIVITETEVE TË
ZHVILLUARA DHE PASQYRËS FINANCIARE

2024





Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	5
OBJEKTIVAT E ARRITURA GJATË VITIT 2024	5
1. AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS	5
1.1. ORGANET DREJTUESE	6
1.1.1. DREJTORI EKZEKUTIV	6
1.2. STRUKTURA ADMINISTRATIVE	6
1.2.1. Drejtoria e Diasporës	6
1.2.2. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	6
1.2.3. Njësia e Menaxhimit të Projekteve	7
2. USHTRIMI I DETYRAVE FUNKSIONALE	7
2.1. Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025	7
Shtyllat kryesore të Strategjisë	8
2.2. Këshilli Kordinues i Diasporës	8
Dita Kombëtare e Diasporës-18 Dhjetor dhe Mbledhja zyrtare e Këshillit Koordinues të Diasporës.	9
2.3. AKTIVITETE DHE PROJEKTE TË INICIUARA APO REALIZUARA NGA AGJENCIA PËRGJATË VITIT 2024	10
2.3.1. Shkolla Verore “Jam Shqiptar”	10
2.3.2. “Trajnim për valltarët nga diaspora”, në bashkëpunim me Shoqatën “Bashkimi” Uster, Zvicër dhe Teatrin e Operas dhe Baletit	10
2.3.3. GAGF Festival, zhvilluar në datat 2-3 tetor 2024, në Berlin.	11
2.3.4. Bashkëpunim me Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare, në kuadër të realizimit të aktiviteteve:	11
2.3.4.1. “Mendjeartët 2024”	11
2.3.4.2. Samiti i pestë i Gruas së Diasporës Shqiptare	11
2.3.5. Agjencia kombëtare e Diasporës ka qenë e pranishme në aktivitetet:	12
2.3.5.1. Kuvendi Kombëtar për Gjuhën Shqipe	12
2.3.5.2. “Ditët e librit arbëresh”, edicioni i dytë	12
2.3.6. Bashkëpunime në projekte:	12
2.3.6.1. Projekti lëvizës “Libri - Forca e Fjalës”	12
2.3.6.2. Eventi “Digital Nomad”, me Bashkinë e Tiranës	12
2.3.6.3. Fushata ndërgjegjëse, “Dhuro libra”	13
2.3.7. “Ti je shqipja ime – Një letër për gjyshin/gjyshen”	13
2.3.8. Projekt në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë dhe Ditës së Alfabetit	13
2.3.9. Dosjet e Diasporës dhe profilizimi i saj (Road Map)	13



2.3.10.	Projekt-VKM për rrjetin ndërkombëtar të të rinjve	13
3.	DATABAZA E STUDENTËVE	13
4.	MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI	14
5.	NEWSLETTER PËR DIASPORËN	14
6.	RAPORTIM DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	15
6.1.	ANALIZË FINANCIARE JANAR-DHJETOR 2024	15
6.2.	Realizimi	16
	TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI (PLAN-FAKT).....	16
6.2.1.	Për fondin e pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600,601)	17
6.2.2.	Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, llogaria ekonomike 602)	17
6.2.3.	Shpenzime kapitale (llogaria ekonomike 231).....	17
6.2.4.	Fond i veçantë (llogaria ekonomike 606)	18
6.3.	DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE (FUNKSIONIMI)	18
6.3.1.	Financa.....	18
6.3.2.	Burime Njerëzore.....	18
6.3.3.	Protokolli.....	19
6.3.4.	Magazina.....	20
6.3.5.	Prokurime	20
	SFIDA NË TË ARDHMEN	20
	PROGRAMI 2025	20
	OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN NËPËRMJET PROGRAMIT	21
	PRITSHMËRITË	21
	METODOLOGJIA.....	21
	PËRMBYLLJE.....	22



HYRJE

Agjencia Kombëtare e Diasporës është ndër institucionet kryesore shtetërore, përgjegjëse për zbatimin e politikës së qeverisë shqiptare, në marrëdhëniet e diasporës shqiptare me vendin e origjinës. Ajo ka për mision, nxitjen dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional, me komunitetet shqiptare në diasporë, me qëllim zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në zhvillimin ekonomik, politik, social dhe kulturor të Shqipërisë.

Raporti Vjetor 2024 është një përmbledhje e veprimtarisë dhe aktiviteteve të realizuara nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, kundrejt objektivave kryesorë vjetorë dhe atyre strategjikë. Agjencia Kombëtare e Diasporës gjatë vitit 2024 ka vepruar në përputhje me drejtimin strategjik dhe në një frymë me politikat qeveritare në fushën e diasporës. Raporti shërben për të informuar institucionet përgjegjëse dhe publikun rreth veprimtarisë të Agjencisë gjatë vitit 2024. Disa prej çështjeve kryesore të trajtuara në raport janë: statusi ligjor i Agjencisë Kombëtare të Diasporës; struktura e institucionit, veprimtaria e institucionit gjatë vitit 2024, aktivitetet institucionale, aktet ligjore bazë për veprimtarinë e AKD si dhe analiza financiare për vitin 2024.

OBJEKTIVAT E ARRITURA GJATË VITIT 2024

- Konsolidimi i bashkëpunimit institucional me diasporën, bashkëveprimi me organizatat vepruese në diasporë, përfaqësitë diplomatike shqiptare, Keshillin Kombëtar të Diasporës, institucionet e tjera që trajtojnë politikat me diasporën;
- Ruajtja e identitetit gjuhësor e kulturor si dhe fuqizimi i lidhjeve me komunitetet shqiptare në botë;
- Nxitja e bashkëpunimit ekonomik nëpërmjet investimeve nga diaspora;
- Ndërgjegjësimi dhe lehtësimi i përfshirjes së diasporës në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit;
- Pasurimi i bazës së të dhënave të diasporës shqiptare;
- Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale të diasporës;
- Integrimi i pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë.

1. AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Agjencia Kombëtare e Diasporës (AKD) është person juridik publik buxhetor, në varësinë e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e krijuar dhe që funksionon bazuar në Vendimin nr.120 datë 6.3.2024 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” me seli në Tiranë.





1.1.ORGANET DREJTUESE

Në përputhje me Kreun 1 pika 3 e VKM nr.120 datë 6.3.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Diasporën”, Agjencia drejtohet nga titullari i Agjencisë, i cili organizon e drejton veprimtarinë e saj, përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët dhe përgjigjet para ministrit.

1.1.1. DREJTORI EKZEKUTIV

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Diasporës është autoriteti më i lartë ekzekutiv i saj. Ai është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Agjencisë. Drejtori Ekzekutiv përfaqëson Agjencinë Kombëtare të Diasporës në marrëdhënie me të tretët.

Gjatë vitit 2024, kjo detyrë ushtrohet nga znj.Ermonela Xhafa, e cila mban statusin administrativ, Drejtues i Trupës së Nivelit të lartë Drejtues (TND). Drejtori Ekzekutiv raporton periodikisht, për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Diasporës tek Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme.

1.2. STRUKTURA ADMINISTRATIVE

Struktura administrative e Agjencisë Kombëtare të Diasporës është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.111, datë 10.09.2020 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe përbëhet nga: Drejtori Ekzekutiv, Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Projekteve.

1.2.1. Drejtoria e Diasporës

Drejtorja e Diasporës është përgjegjëse:

- Për koordinimin me qëllim vëzhgimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit të saj;
- Për planifikimin, organizimin dhe zbatimin e detyrimeve të lidhura me qëllimet dhe aktivitetin e Agjencisë.

1.2.2. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjëse:

- Për administrimin e buxhetit të miratuar dhe veprimtarinë financiare të Agjencisë;



AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS


- Për përgatitjen e projekt-buxhetit dhe për administrimin e çdo çështjeje që lidhet me hartimin e planit financiar buxhetor afatmesëm e vjetor me qëllim arritjen e objektivave të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

1.2.3. Sektori i Menaxhimit të Projekteve

Njësia e Menaxhimit të Projekteve është përgjegjëse:

- Për planifikimin, drejtimin dhe zbatimin e projekteve në përputhje me misionin e institucionit dhe në nxitje të sipërmarrjes së Diasporës për zhvillimin social-ekonomik dhe kulturor.
- Koordinon me donatorët e projekteve në realizimin e objektivave dhe veprimtarisë të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për Zhvillimin e Diasporës:

STRUKURA E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS



2.USHTRIMI I DETYRAVE FUNKSIONALE

2.1.Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025

Agjencia Kombëtare e Diasporës, bazuar në kreun III, pika 2/c të VKM nr.120 datë 6.3.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” ndjek zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës; (Strategjia përbëhet nga 72 masa në total dhe 68 indikatorë).

“Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021 – 2025” përcakton parimet e politikës shtetërore të Republikës së Shqipërisë, për mbështetjen e komuniteteve shqiptare të cilat jetojnë në vendet pritëse, në mënyrë të ligjshme. Vizioni i saj ka për synim rivlerësimin e angazhimit të diasporës, duke u bazuar në strukturën e marrëdhënieve aktuale të shtetit shqiptar me diasporën.



Shtyllat kryesore të Strategjisë

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 është e mbështetur në pesë qëllime kryesore strategjike, me anë të të cilave synohet arritja e objektivave të sipërpërmendura:

1. Qeverisja dhe menaxhimi i njohurive
2. Avancimi i programit të të drejtave politike dhe sociale të diasporës
3. Programi për kapitalin e diasporës dhe lidhjet e tyre në ruajtjen e kulturës kombëtare
4. Përfshirja e diasporës në programin e zhvillimit ekonomiko-social të vendit
5. Monitorimi dhe Vlerësimi.

Bazuar në Urdhërin e Kryeministrit nr. 30, datë 17. 2. 2021 “Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve, për zbatimin e planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025”, koordinatorët e referuar nga institucionet përgjegjëse raportojnë periodikisht dhe mbajnë një raport të ngushtë komunikimi dhe bashkëveprimi me Agjencinë.

Institucione përgjegjëse për zbatimin e masave janë si më poshtë:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (kryesuese), Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, INSTAT-i, Akademia e Shkencave, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Bazuar në Planin e Veprimit 2021-2025, vërehet se nuk ka masa të reja për zbatim nga institucionet përgjegjëse për vitet 2024 dhe 2025. Pjesa më e madhe e masave për tre vitet e para (2021, 2022, 2023) janë në vazhdimësi deri në vitin 2025. Meqënëse të 72 masat janë përqendruar në vitet pararendëse dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre janë periodike për zbatim, institucionet përgjegjëse duhet të referojnë, mbi përditësime apo zhvillime të mundshme në kuadër të realizimit të masave përkatëse, deri në fund të vitit 2025.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka përgatitur një raport analitik mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025, vështirësitë e hasura gjatë zbatimit dhe rekomandimet për vitin 2025, lidhur me hartimin e Strategjisë së re për Diasporën.

2.2.Këshilli Kordinues i Diasporës

Këshilli Kordinues i Diasporës është organi përfaqësues i marrëdhënieve të Diasporës me institucionet shtetërore shqiptare. Në mbledhjet e tij të rregullta, marrin pjesë



përfaqësuesit më të lartë të institucioneve shtetërore. Ai është ngritur dhe kryen veprimtarinë e tij mbi bazën e Ligjit Nr. 16/2018 “Për Diasporën” i ndryshuar. Në përputhje me këtë ligj, Agjencia Kombëtare e Diasporës kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Koordinues të Diasporës. Agjencia koordinon mbledhjet dhe takimet me anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës. Përbërja dhe anëtarët aktualë të Këshillit Koordinues të Diasporës, janë caktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 630, datë 8.11.2023 “Për caktimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës”.

Veçantia e këtij organi, si i pari në historinë e shtetit shqiptar për të përfaqësuar interesat e shqiptarëve të larguar nga vendlindja, është përkushtimi dhe roli proaktiv i anëtarëve të tij në përmbushjen e misionit madhor në forcimin e urave lidhëse me vendin amë duke kontribuar në konsolidimin e një diaspore të vetëdijshme për misionin e saj atdhetar, në ruajtjen, kultivimin dhe përhapjen e gjuhës, kulturës dhe traditave më të mira shqiptare. KKD vijon të mbështesë dhe orientojë potencialet intelektuale të diasporës në shërbim të zhvillimit shoqëror, politik dhe ekonomik të kombit, duke përfaqësuar zërin e komuniteteve shqiptare në shtetet pritëse.

Dita Kombëtare e Diasporës-18 Dhjetor dhe Mbledhja zyrtare e Këshillit Koordinues të Diasporës.

Data 18 dhjetor, e percaktuar në ligjin nr. 16/2018 “Për Diasporën” i ndryshuar, si “Dita Kombëtare e Diasporës”, shënon një ditë të rëndësishme në fuqizimin e ndjenjës së identitetit dhe vlerave kombëtare të shqiptarëve në diasporë.

Ashtu sikurse çdo vit, qëllimi i mbledhjes vjetore të KKD ishte forcimi i urave lidhëse me diasporën, përmes përfaqësuesve të saj dhe institucioneve shqiptare, duke krijuar një kuadër të plotë institucional në këtë drejtim, duke zhvilluar një vizion bashkëpunues, përmes dialogut kuptimplotë dhe të strukturuar si dhe kultivimi i partneriteteve të cilat shërbejnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Në ushtrim të funksionit të saj si sekretariat teknik, Agjencia mbështet çdo vit organizimin dhe zhvillimin e mbledhjes vjetore të KKD. Për vitin 2024, mbledhja u organizua gjatë datave 18 dhe 19 dhjetor.

Në datën 18 dhjetor, në mjediset e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, u zhvillua një ekspozitë me veshje artizanale shqiptare. Dita vijoi me takime të anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës me përfaqësues të lartë të shtetit shqiptar.

Gjatë pjesës së dytë të ditës, u mbajt koncerti “Arti në Diasporë”, koncert i cili përfshiu gërshetimin e zhanreve të ndryshme, me pjesëmarrjen e artistëve kryesisht nga diaspora, ku u evidentua figura e Tefta Tashko - Koços, një nga artistet më me ndikim në diasporë, në interpretimin e znj. Feride Istogu, znj. Adelina Paloja, pianistes znj. Almira Emiri.



Mbledhja zyrtare e datës 19 dhjetor u zhvillua në mjediset e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe u organizua në tre seanca.

Seanca e parë u zhvillua me praninë e autoriteve të larta si: SH.T.Z Edi Rama, Kryeministër, SH.T.Z. Igli Hasani, Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Mark Gjonaj, Kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës, ministrat përgjegjes për zbatimin e zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës, institucione të tjera të përfshira në fushën e diasporës si edhe 13 anëtarë të tjere të KKD.

Në seancën e dytë, mbledhja vijoi me personalitetet:

z. Igli Hasani, Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Ervin Hoxha – Ministër i Brendshëm, znj. Lira Pipa- Zv.Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, znj. Ogerta Manastirliu - Ministër i Arsimit dhe Sportit, z. Petrit Malaj- Ministër i Financave, znj. Liza Gashi – zv. Ministre për Punët e Jashtme dhe Diasporës, Kosovë, z. Lavdrim Krrashi - Kryetar i Nënkomisionit Parlamentar për Diasporën dhe Migracionin, z. Ilirjan Celibashi - Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, z. Skënder Gjinushi - Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe institucione të tjera pjesëmarrëse.

Seanca e fundit ishte në funksion të diskutimeve të brendshme midis KKD, AKD e MEPJ.

2.3.AKTIVITETE DHE PROJEKTE TË INICIUARA APO REALIZUARA NGA AGJENCIA PËRGJATË VITIT 2024

2.3.1. Shkolla Verore “Jam Shqiptar”

Disa nxënës nga shkollat e gjuhës shqipe në Itali, u bënë pjesë e kësaj iniciative për 10 ditë. Me qëllim nxitjen e organizimit të veprimtarive kulturore, gjuhësore dhe turistike për formimin kulturor, gjuhësor, njohjen me vendet turistike dhe historinë e Shqipërisë të nxënësve shqiptarë në diasporë, për të përmirësuar dhe garantuar ruajtjen e identitetit kombëtar, kulturor dhe gjuhësor si dhe trashëgiminë e këtyre vlerave, brez pas brezi. AKD dhe QBD realizuan bashkërisht programin Shkolla Verore “Jam Shqiptar”, në datat 21 - 30 qershor 2024.

2.3.2. “Trajnim për valltarët nga diaspora”, në bashkëpunim me Shoqatën “Bashkimi” Uster, Zvicër dhe Teatrin e Operas dhe Baletit

Agjencia Kombëtare e Diasporës solli në jetë një projekt, i cili u mundëson të rinjve shqiptarë në diasporë, të mësojnë dhe praktikojnë vallet folklorike shqiptare, në mënyrë që t'i transmetojnë ato tek brezat e rinj në vendin pritës, duke u bërë kështu trajnues të tyre. Ndërmjetësimi dhe mundësimi i mësimi të valleve popullore u realizua bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Qëllimi ishte konsolidimi i një marrëdhënieje të ngushtë me diasporën, për t'i ardhur në ndihmë veçanërisht brezit të ri, për t'i afruar ata



me rrënjët e tyre, për të njohur Shqipërinë, trashëgiminë kulturore, folklorin e pasur, doket e zakonet shqiptare, si edhe për të siguruar transmetimin e traditës tek brezat e rinj.

2.3.3. GAGF Festival, zhvilluar në datat 2-3 tetor 2024, në Berlin.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka mbështetur realizimin e GAGF Festival, zhvilluar në datat 2-3 tetor 2024, në Berlin me qëllim rrjetëzimin e bizneseve shqiptare dhe sipërmarrësve nga diaspora.

Global Albanian Gastronomy Festival (GAGF), mbledhi gastronomë, biznesmenë, personalitete të larta nga Shqipëria, si dhe personalitete nga Kosova e Gjermania, në një program të pasur, i cili përfshiu zhvillimin e panairit tregtar, panele diskutimi, shfaqje të gatimeve shqiptare dhe mbrëmje gala. Aktiviteti ishte me vlerë për faktin se krijoi mundësi rrjetëzimi për bizneset shqiptare dhe ato të diasporës, duke rritur kështu mundësitë e bashkëpunimeve midis tyre. Agjencia dha kontributin e saj, pa harruar edhe fushën kulturore, duke sjellë në vëmendje veshjet tradicionale shqiptare, gjatë zhvillimit të panairit.

2.3.4. Bashkëpunim me Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare, në kuadër të realizimit të aktiviteteteve:

2.3.4.1. “Mendjeartët 2024”

Bright Mind Albanian Worldwide Awards 2024, u zhvillua në Tiranë, me bashkëatdhetarët e spikatur të sipërmarrjes, bizneseve dhe menaxhimit në botë. Qëllimi i këtij aktiviteti, ishte të njihte dhe festonte arritjet dhe historitë e suksesit të diasporës, duke ofruar një mundësi të jashtëzakonshme jo vetëm për promovim, por edhe për t'u bërë pjesë e një zinxhiri vlerash ku mbizotëron fryma e patriotizmit. Me disa kategori prestigjioze, ky event bëri bashkë institucione, mëndje të bukura dhe personazhe nga diaspora, duke ofruar një platformë rrjetëzimi që shfaqti sukses, inovacion dhe solidaritet njerëzor.

2.3.4.2. Samiti i pestë i Gruas së Diasporës Shqiptare

Samiti u zhvillua në datat 11 dhe 12 tetor, në Tiranë, nën titullin “Leading the Way to the European Union”, u organizua në tre panele dhe u përmbyll me vizita në disa biznese. Samiti pati në fokus rolin e veçantë, që gratë nga komuniteti i biznesit por dhe ato profesioniste nga diaspora shqiptare, mund të luajnë në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Gjatë Samitit u shtruan çështjet kryesore si më poshtë:

- Konteksti socio-ekonomik në mbështetje të procesit integruar, sfidat dhe mundësitë.



- Udhëzimi i biznesve drejt integritimit në tregun europian, me fokus nxjerrjen në pah të rolit të grave sipërmarrëse të diasporës për integrim dhe ndërkombëtarizim të suksesshëm të bizneseve shqiptare në tregun e BE.
- Gratë në inovacion dhe digjitalizim, rrugëtimi drejt ekonomisë digjitale në Shqipëri.
- Forcimi i dialogut publik-privat, angazhimi i gruas së diasporës për integrim në Bashkimin Europian.

2.3.5. Agjencia kombëtare e Diasporës ka qenë e pranishme në aktivitetet:

2.3.5.1. Kuvendi Kombëtar për Gjuhën Shqipe

Zhvilluar në Pallatin e Brigadave në Tiranë, më 21 nëntor 2024, kjo ceremoni e veçantë bashkoi përfaqësues të institucioneve arsimore figura të shquara nga arsimi, gjuhësia, letërsia, kërkimi shkencor dhe komunikimi publik, me qëllim evidentimin e rëndësisë së gjuhës shqipe, si shtylla kryesore e identitetit kombëtar dhe e historisë sonë. Agjencia, e cila përfaqësohej nga Drejtori Ekzekutiv, ishte pjesë e njërit prej paneleve të diskutimit.

2.3.5.2. “Ditët e librit arbëresh”, edicioni i dytë

Zhvilluar në Tiranë në datat 30 shtator dhe 1 tetor 2024 me qëllim krijimin e hapsirës për studiuesit arbëreshë të pranishëm, artizanët arbëreshë, përfaqësimi studiuesve arbëreshë, për të shpalosur veprat dhe punën e tyre shumëvjeçare, në drejtim të veshjes arbëreshe.

2.3.6. Bashkëpunime në projekte:

2.3.6.1. Projekti lëvizës “Libri - Forca e Fjalës”

Aktiviteti u zhvillua në mjediset e Ambasadës së Shqipërisë në Romë, Itali. Ky projekt, i cili është ideuar të implementohet në të gjitha vendet e Europës, ka synim të përfshijë shoqërinë shqiptare në diasporë, duke përdorur librin si një lidhje me gjuhën por edhe duke funksionuar si një mjet ndërgjegjësimi, për çështje sociale, përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta dhe ata që përballen me dhunë familjare.

2.3.6.2. Eventi “Digital Nomad”, me Bashkinë e Tiranës

Ky event ka synim të bashkojë nomadë digjital nga e gjithë bota, profesionistë, sipërmarrës dhe të rinj, që eksplorojnë botën nëpërmjet të punuarit në distancë ose aspirojnë të përgatiten, për një profesion të tillë. Agjencia Kombëtare e Diasporës bashkëpunoi, duke ndërmjetësuar në pjesëmarrjen e ekspertëve digjital nga diaspora, të cilët përfaqësuan një panel të veçantë dedikuar diasporës. Aktiviteti ofron mundësi të



AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

shumta, të cilat janë në fokus të Agjencisë Kombëtare të Diasporës si: përditësimin e mëtejshëm me zhvillimet dhe metodat inovative; rrjetëzimin e të rinjve; shkëmbimin e eksperiencave; identifikimin e mundësive për investim/ bashkëpunimin dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

2.3.6.3. Fushata ndërgjegjëse, “Dhuro libra”

Në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme u organizua fushata ndërgjegjëse “Dhuro libra”, për shqiptarët në rajon dhe Diasporë. Sa i përket kësaj nisme, Agjencia Kombëtare e Diasporës ishte pjesë e komunikimit me shtëpitë botuese dhe mbledhjes së librave të ndryshëm, me karakter letrar dhe shkollor, të cilët kishin si destinacion, shqiptarët e rajonit.

2.3.7. “Ti je shqipja ime – Një letër për gjyshin/gjyshen”

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka realizuar projektin “Ti je shqipja ime – Një letër për gjyshin/gjyshen”, një konkurs me fëmijët në diasporë, të cilët u ftuan të bëheshin pjesë, duke shkruar një letër në shqip. Letrat u publikuan në rrjetet sociale të Agjencisë.

2.3.8. Projekt në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë dhe Ditës së Alfabetit

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka paraqitur në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme projekt-ide mbi realizimin e 2 dy inserteve, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë dhe Ditës së Alfabetit. Këto video u shpërndanë në rrjetet sociale të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

2.3.9. Dosjet e Diasporës dhe profilizimi i saj (Road Map)

Gjatë vitit 2024, Agjencia kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike shqiptare të akredituara jashtë vendit, ka punuar në drejtim të profilizimit dhe karakteristikave të secilit komunitet, duke krijuar dosjet përkatëse, sipas shteteve pritëse.

2.3.10. Projekt-VKM për rrjetin ndërkombëtar të të rinjve

Projekt-Propozim mbi ngritjen e rrjetit ndërkombëtar të të rinjve në diasporë (platformë) nën emërtimin Këshilli i të Rinjve të Diasporës. (Projekt-VKM)

3. DATABAZA E STUDENTËVE

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 504, datë 24.06.2020, për "Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve që studiojnë jashtë vendit dhe





shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë", është ngritur një sistem i brendshëm i databazës, i cili është produkt i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Ky projekt, ka si objekt grumbullimin dhe përditësimin e të dhënave, për studentët dhe shtetasit e huaj, që përfitojnë bursa studimi nga shteti shqiptar. Aktualisht, informacioni për studentët që kanë përfituar nga fondet e Ekselencës, për vitin akademik 2014-2020 është hedhur në databazë, duke bërë kështu një hap të rëndësishëm, në krijimin e një baze të qëndrueshme dhe të përditësuar të të dhënave.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 504, datë 24.06.2020, ofrues të informacionit, për bazën e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, janë Ministria përgjegjëse për Arsimin dhe Ministria përgjegjëse për Punët e Jashtme.

Për vitin akademik 2020-2024, është dërguar një kërkesë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për përditësimin e kësaj baze të dhënash dhe aktualisht jemi në pritje të informacionit.

4. MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Gjatë vitit 2024 është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve:

- Marrëveshje bashkëpunimi lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën, me qëllim promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe Gjuhës Shqipe në Diasporë.

5. NEWSLETTER PËR DIASPORËN

"Newsletteri i Diasporës" është një buletin informativ mujor që pasqyron aktivitetet e institucioneve të Diasporës dhe ato që zhvillohen në diasporë. Ky buletin ka për qëllim të informojë publikun e gjerë mbi zhvillimet dhe ecurinë e praktikave dhe projekteve që lidhen me diasporën shqiptare. Duke marrë parasysh dinamikën e aktiviteteve të diasporës, Newsletteri është zhvilluar me një frekuencë mujore, duke reflektuar aktivitetet më të rëndësishme dhe informacionin e nevojshëm, për të mbajtur gjallë lidhjen, me komunitetet shqiptare jashtë vendit.



6. RAPORTIM DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

6.1. ANALIZË FINANCIARE JANAR-DHJETOR 2024

Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të vitit 2024 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr.120 datë 6.3.2024 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” pika IV/1, Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021-2025.


Ky raport përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2024 dhe pasqyron funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Bazuar në shkresën nr.2 Prot., datë 03.01.2024 dhe shkresën nr.11860/1 datë 12.09.2024, Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2024, i është transferuar fondi buxhetor prej 95,477,000 (nëntëdhjetë e pesë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë, i detajuar si më poshtë:

– Shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore)	27,677,000 lekë;
– Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime, bursa)	59,700,000 lekë;
– Shpenzime kapitale (investime)	8,000,000 lekë.
– Fond i vecantë	100,000 lekë.

Gjithsej

95,477,000 lekë






6.2.Realizimi

Agjencia Kombëtare e Diasporës, referuar buxhetit të vitit 2024, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në përfundim të vitit buxhetor Janar-Dhjetor 2024, rezulton se shpenzimet faktike janë realizuar si më poshtë:

TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI (PLAN-FAKT)

Llog.ek	Përshkrimi	Buxheti Plan 2023	Buxheti Fakt 2023	Buxheti i realizuar %
600	Shpenzime për Paga	23,830,000.00	17,516,084.00	74 %
601	Shpenzime për Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	3,847,000.00	2,871,045.00	75 %
602	Shpenzime Korrente	59,700,000.00	21,110,113.00	35 %
231	Shpenzime Kapitale	8,000,000.00	-	0%
606	Fond i vecantë	100,000.00	9,282.00	9%





6.2.1. Për fondin e pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600,601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë kësaj periudhe numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 11 punonjës, nga 16 punonjës të miratuar me Urdhrin Nr.111, Datë 10.09.2020 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës” e përbërë nga Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si dhe Sektori i Projekteve.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 17,516,084 (shtatëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e katër) lekë ose 74 % e fondit të planifikuar për vitin 2024 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 2,871,045 (dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e njëmijë e dyzet e pesë) lekë, ose 75 %, e planifikimit për periudhën respektive.

6.2.2. Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, llogaria ekonomike 602)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024, fondi i shpenzime korrente është realizuar në vlerën 21,110,113 (njëzet e një mijë e njëqind e dhjetë mijë e njëqind e trembëdhjetë) lekë ose 35 % e fondit të planifikuar.

Në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë kësaj periudhe, shpenzimet korrente, kanë konsistuar në:

7. Shpenzime të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime.
8. Shpenzime të përgjithshme administrative.
9. Shpenzime për programin e Shkollës Verore “Jam Shqiptar”.
10. Shpenzime në kuadër të ruajtjes së kulturës dhe identitetit kombëtar (trajnim i valltarëve nga Diaspora pranë koreografëve të TOB).
11. Shpenzime në kuadër të Festivalit të Gastronomisë Shqiptare.
12. Shpenzime për mbështetjen dhe promovimin e artistëve/figurave të shquara nga Diaspora.
13. Shpenzime në kuadër të bashkëpunimit me Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare.
14. Shpenzime në kuadër të Ditës së Diasporës.

6.2.3. Shpenzime kapitale (llogaria ekonomike 231)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 fondi i shpenzimeve kapitale nuk është realizuar.



6.2.4. Fond i veçantë (Ilogaria ekonomike 606)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 fondi i vecantë është përdorur për pagesat e shërbimit të komunikimeve elektronike në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 673 datë 2.9.2020 “Për pajisjen me Numër Telefoni Celular të Funkionarëve Publikë”.

6.3. DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE (FUNKSIONIMI)

6.3.1. Financa

Gjatë kësaj periudhe sektori i financës ka evidentuar me përpikmëri nëpërmjet kontabilizimeve në ditarët përkatës (ditari i magazinës si dhe shpenzimeve të arkës dhe të bankës) të gjitha shpenzimet e kryera në valutë si edhe në lekë.

Në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar si dhe udhëzimin në zbatim të tij dhe kontrollin, sektori i financës ka përgatitur të gjitha urdhër-shpenzimet në afatin e caktuar për faturat e paraqitura nga kryerja e prokurimeve publike, pagesat për pagat, honoraret dhe dietat e punonjësve. Janë përgatitur dhe likuiduar 146 urdhër shpenzime. Janë përgatitur brenda afatit të gjitha listë pagesat për pagat si dhe listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve. Gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesat e pagave të punonjësve nëpërmjet listë pagesave dhe urdhër shpenzimeve. Bazuar në Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve”, në fund të vitit kryhet inventarizimi i aktiveve.

Janë përgatitur raportimet periodike për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, rakordimet me Degën e Thesarit si dhe çdo informacion tjetër me karakter financiar.

6.3.2. Burime Njerëzore

Struktura aktuale e Agjencisë Kombëtare të Diasporës është miratur me Urdhërin Nr.111, datë 10.09.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Marrëdhëniet e punës për Drejtorin Ekzekutiv dhe nëpunësit e Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjisllacionin në fuqi për nëpunësin civil. Sipas strukturës së miratuar, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka 16 pozicione pune në total. Gjatë vitit 2024, numri mesatar i punonjësve të emëruar është 12.

Burimet njerëzore janë një faktor i rëndësishëm në realizimin e objektivave kryesorë institucionalë. Në këtë kontekst, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka patur si objektiv prioritar jo vetëm ngritjen e kapaciteteve të brendshme por dhe ruajtjen e një strukture organike që do ti mundësonte eficiencë në realizimin e misionit të saj. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është i orientuar drejt administrimit me korrektësi të dosjeve të



personelit, si dhe vlerësimin vjetor të performancës në punë për çdo punonjës, në kohë dhe në përputhje me rregullat administrative përkatëse si dhe identifikimit të nevojave të personelit për përmirësimin e aftësive profesionale të tyre nëpërmjet realizimit të trajnimeve në përshtatje me nevojat profesionale të vendit të punës me qëllim përballimin e sfidave të ndryshme në të ardhmen.

Gjatë vitit 2024, nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës kanë ndjekur trajnime të ndryshme të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), CRDFGLOBAL, ACT Center. Temat e trajnimeve kanë qenë gjithëpërfshirëse, si: "Prezantimi me administratën publike", "Menaxhimi i burimeve njerëzore", "Higjiena kibernetike dhe praktikrat më të mira të sigurisë, "Antikorrupsioni", "Veprimet juridike të interpretuara sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë", "Llojet e kontratave në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", "Konsiderata të përgjithshme për menaxhimin e zbatimit të projekteve", "Analiza financiare në fizibilitetin e projekteve", "Formulimi i projekteve", "Menaxhimi i fondeve IPA", "Menaxhimi i projekteve", "Menaxhimi i riskut", "Comprehensive Training for Cyber Hygiene, Open-Source Intelligence (OSINT) and Social Engineering: Protection of Your Digital Presence"..etj.

Për të mundur realizimin me efikasitet të objektivave dhe misionit të institucionit, në bashkëpunim me DAP-in, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore janë ndjekur procedurat për plotësimin e vendeve vakante.

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në përputhje me Ligjin "Për nëpunësin civil" dhe aktet nënligjore ka realizuar përgatitjen e dosjeve të personelit, raportimet periodike në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe ka administruar procesin e vlerësimit të performancës në punë për punonjësit e institucionit.

Gjatë këtij viti në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ligji "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe nëpunësve publik", autoriteti përgjegjës ka ndjekur depozitimin në kohë të formularit të Deklarimit të Interesave Privatë Periodik/Vjetor për subjektet që kanë detyrim deklarimi dhe ka realizuar raportimet pranë ILDKPKI-së.

6.3.3. Protokolli

Në bazë të ligjit "Për Arkivat", është bërë pritja e shkresave të hyra në institucionin, duke i vendosur kartelën shoqëruese, numrat e protokollit dhe përcjelljen e tyre drejt drejtuesit të Institucionit, i cili bën shpërndarjen e shkresave sipas drejtorive përkatëse. Është kryer procedura ligjore për shkresat dalëse të institucionit tonë, duke verifikuar fillimisht plotësimin e kushteve dhe parametrave që përcakton ligji ynë në pjesën e ndërtimit të shkresave, vendosjen e numrit të protokollit, dërgimit të tyre drejt drejtuesit të Institucionit për firmosje dhe vulosje dhe së fundmi klasifikimin e dokumenteve sipas strukturave organizative të institucionit.



6.3.4. Magazina

Në hyrjen dhe shpërndarjen e artikujve nga magazina është ndjekur procedura ligjore duke bërë evidentimet e nevojshme në fletë-hyrjet, fletë-daljet dhe janë bërë pasqyrimet në Librin e Magazinës për sasitë artikujve të dala nga magazina dhe gjendjen e tyre të mbetur në magazinë.

Në fund të vitit është kryer inventarizimi i aktiveve bazuar në Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve”.

6.3.5. Prokurime

Në zbatim të planit vjetor për shpenzime, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka hartuar e zbatuar regjistrin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2024 është realizuar nëpërmjet procedurave të prokurimit me vlera të vogla, si dhe blerjeve nën 100.000 lekë pa tvsh. Bazuar në ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar, VKM nr. 28/2020 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe udhëzimeve përkatëse në periudhën Janar-Dhjetor janë kryer dhe realizuar me sukses procedurat e prokurimit publik me objekt të ndryshëm prokurimi duke përfshirë “Blerje bileta transportit ajror ndërkombëtar”, “Shërbim transporti me autobus”, “Blerje librash”, “Blerje bojra printeri”, “Blerje materiale kancelarie”, “Blerje produkte promocionale”, “Shërbim mirëmbajtje dhe riparim kompjuterash”, etj.

Janë krijuar në sistemin elektronik të APP-së gjithsej 17 elemente në regjistrin e parashikimeve për vitin 2024. Nga këto janë realizuar 9 elementë nën vlerën 100,000 lekë, ndërsa 2 procedura prokurimi mbi vlerën 100,000 lekë.

SFIDA NË TË ARDHMEN

PROGRAMI 2025

Programi 2025 është hartuar duke mbajtur në vëmendje angazhimin e diasporës dhe përfshirjen në jetën politike, sociale, ekonomike të vendit të origjinës. Fokusi do të jetë afrimi i të rinjve me Shqipërinë dhe forcimi i ndjenjave të përkatësisë shqiptare, duke i afruar me gjuhën dhe kulturën tonë. Në këtë kuadër është planifikuar të ketë disa projekte me në fokus rininë nga diaspora. Gjithashtu, për realizimin e programit për vitin 2025, do të ketë një bashkëpunim të ngushtë me përfaqësitë shqiptare në botë, përfaqësues të diasporës shqiptare dhe institucione të tjera përgjegjëse për diasporën, ku do të koordinohen aktivitetet me diasporën. Rëndësi do t'i kushtohet edhe promovimit të figurave të spikatura në diasporë, si artistë, mësues, studiues, sipërmarrës, veprimtarë etj. Programi i Agjencisë për vitin 2025 do t'i kushtojë rëndësi edhe bashkëpunimit ekonomik me diasporën, nëpërmjet organizimit të konferencave me aktorë të ndryshëm, të cilët kanë një rol në këtë drejtim.



OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN NËPËRMJET PROGRAMIT

1. Konsolidimi i bashkëpunimit institucional me diasporën;
2. Ndërgjegjësimi dhe lehtësimi i përfshirjes së diasporës në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit;
3. Ruajtja e identitetit dhe fuqizimi i lidhjeve me komunitetet shqiptare në botë;
4. Nxitja e bashkëpunimit ekonomik nëpërmjet investimeve nga diaspora;
5. Ruajtja e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare si dhe zhvillimi i identitetit të pjesëtarëve të diasporës
6. Pasurimi i bazës së të dhënave të diasporës shqiptare;

PRITSHMËRITË

1. Krijimi dhe forcimi i lidhjeve të forta emocionale, ekonomike, sociale dhe kulturore me komunitetet shqiptare në botë;
2. Rritja e ndërgjegjësitimit dhe ngjalljes së ndjenjës së atdhedashurisë për vendin e origjinës;
3. Pasurimi i bazës së të dhënave me pjesëtarë të rinj nga diaspora e të gjithë target grupeve.
4. Evidentimi i problematikave me të cilat përballlet diaspora dhe referimi për trajtim në strukturat përkatëse;
5. Forcimi i besimit ndaj institucioneve të vendlindjes;

METODOLOGJIA

Organizimi i vizitave në Shqipëri, me grupe të rinjsh nga komunitetet shqiptare në diasporë, nëpërmjet programeve që synojnë njohjen e tyre me Shqipërinë: gjuhën, traditat, kulturën e historinë. Vizitat do t'iu japin mundësi të rinjve të thellohen më shumë në gjuhën shqipe dhe traditat kulturore.

Organizimi i konferencave apo tryezave të rrumbullakëta, me qëllim trajtimin dhe diskutimin e tematikave të rëndësishme që lidhen me diasporën, me pjesëmarrjen e aktorëve me role kyçe.

Mirëmbajtja dhe pasurimi i bazës së të dhënave, përmes mbledhjes sistematike, gjithëpërfshirëse dhe hartëzimin e diasporës, si dhe përfshirjen e një game të gjerë të anëtarëve të diasporës, në praktika konsultimi, nëpërmjet së cilës do të arrihet të kuptohet se çfarë ofron diaspora, çfarë është e gatshme të ofrojë, dhe çfarë pritet në këmbim nga qeveria.

Anëtarët e Diasporës në mbarë botën, konsiderohen si forcë lëvizëse dhe potenciali i tyre, mund të dalë në pah, vetëm nëse ekzistojnë mekanizma të përshtatshëm angazhimi dhe nëse organizatat dhe organet e tyre përfaqësuese, fuqizohen për t'u bërë pjesë e një



marrëdhënieje të besueshme, ndërmjet diasporës, institucioneve dhe publikut të gjerë në vend.

Bashkëveprimi i ngushtë me përfaqësitë diplomatike në vendet ku ka një numër të konsiderueshëm të diasporës sonë, me organizatat dhe shoqatat e diasporës, të cilat përfaqësojnë zërin e anëtarëve të diasporës në vendet pritëse, mund të luajnë një rol të rëndësishëm, në proceset strategjike vendimmarrëse në Shqipëri, si dhe mund të nxisin nisma të çmuara për bashkëveprimin shoqëror, ekonomik dhe intelektual ndërmjet diasporës dhe Shqipërisë.

PËRMBYLLJE

Raporti i vitit 2024 është dokumenti gjithëpërfshirës i punës dhe veprimtarisë vjetore të Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Përfundimi i këtij viti, nuk mund të ishte i tillë pa angazhimin e çmueshëm të stafit të Agjencisë, partneritetin e të gjithë aktorëve publik dhe privat, vendas e ndërkombëtar.

